



Niset Kontingjenti i 2-të me mision pranë KFOR-it, në Kosovë

Kontingjenti i 2-të me 30 efektivë nga Forca Tokësore, efektivë të Batalionit Komando (nga Regjimenti i Operacioneve Speciale - ROS) janë nisur për në Kosovë për të shërbyer si pjesë e misionit të KFOR. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i pranishëm në ceremoninë e përcjelljes, e vlerësoi këtë si një moment të veçantë për faktin se këta efektivë nisen në mision si përfaqësues të vendit në përpjekjet

e Aleancës së NATO për t'i shërbyer sigurisë dhe paqes. "Republika e Shqipërisë në vijimësi ka dëshmuar se është jo vetëm faktor paqeje dhe stabiliteti rajonal e më gjerë, por edhe një aleat serioz, i cili merr përsipër dhe mban barrën e detyrimeve dhe në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës", - u shpreh gjatë fjalës së tij z. Peleshi. Ministri i Mbrojtjes theksoi mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë ndaj as-

piratave të Kosovës, por vlerësoi edhe rritjen e pranisë së forcave të vendeve të Aleancës si pjesë e KFOR-it. "Mbështetja e Kosovës në aspiratat e saj kundrejt anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e paqes dhe sigurisë, inkurajon zhvillimin e rajonit dhe frenon zgjerimin e influencës të vendeve të tjera, që sfidojnë demokracinë në vendet e Ballkanit..."

» faqe 2



Luiza Gega shpallet kampione e Europës në garën e 3000 metrave me pengesa Kryeministri Rama: Luiza i dhuroi vendit imazhin e një Shqipërie që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve



Ministri Peleshi: Ngjarje të tilla duhen trajtuar me përgjegjshmëri

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi vizitoi në QSUT dy efektivët e Forcave të Armatosura, që mbetën të lënduar gjatë incidentit në uzinën e Gramshit, ku tre shtetas të huaj, me pasaporta ruse dhe ukrainase tentuan të futeshin brenda ambienteve të uzinës. "Aldon dhe Ardiani paraqitën gjendje shëndetësore të mirë dhe shumë shpejt lanë ambientet e spitalit, ku patën ndihmën e menjëhershme të bluzave të bardha" - tha ministri Peleshi. Ministri i Mbrojtjes kërkoi që të bëhet durim deri...



» Faqe 2

Gjeneral brigade Arben Kingji priti ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Tayyar Kagan Atay

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të SFARSH, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një takim me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Tayyar Kagan Atay dhe atasheun ushtarak turk kolonel Muhamet Kelami Kablay. Gjeneral brigade Kingji në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal, por edhe më tej, në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të përbashkëta dhe të NATO. Bashkëpunimi ushtarak midis dy...



» Faqe 4

Në ambientet e Komandës së FD u zhvillua vlerësimi teorik për vetëdrejtimin autonom të anijeve

Në ambientet e Komandës së Forcës Detare u zhvillua vlerësimi teorik për vetëdrejtimin autonom të anijeve. Testimi teorik do të pasohet nga ai praktik. Ky moment është shumë i rëndësishëm për karrierën ushtarake pasi është pikënisja e një angazhimi të gjatë dhe marrje përgjegjësie për veten dhe efektivat që ata do të komandojnë. Këta oficerë janë pjesa më vitale e Forcës Detare, pasi janë gjithmonë në vijën e parë në kryerjen e detyrave të tilla si dhënia e ndihmës ndaj njerëzve dhe mjeteve në rrezik...



» Faqe 5

Incidenti në uzinën e Gramshit

Ministri Peleshi: Ngjarje të tilla duhen trajtuar me përgjegjshmëri

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi vizitoi në QSUT dy efektivët e Forcave të Armatosura, që mbetën të lënduar gjatë incidentit në uzinën e Gramshit, ku tre shtetas të huaj, me pasaporta ruse dhe ukrainase tentuan të futeshin brenda ambienteve të uzinës.

“Aldon dhe Ardiani paraqitën gjendje shëndetësore të mirë dhe shumë shpejt lanë ambientet e spitalit, ku patën ndihmën e menjëhershme të bluzave të bardha” - tha ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes kërkoi që të bëhet durim deri në zbardhjen e plotë të ngjarjes, për të cilën po punojnë të gjitha strukturat, që nga Inteligjenca Ushtarake, Policia Ushtarake, Shërbimi Informativ Shtetëror, Policia e Shtetit dhe Antiterrori: “Tre shtetas të huaj u janë afruar ish-Uzinës Ushtarake të Gramshit. Them ish, sepse prej vitesh ajo uzinë nuk ka aktivitet. Një prej shtetasve të huaj ka kapërcyer rrethimin në mënyrë të paligjshme. Në këtë moment dy ushtarakët duke u ngritur në nivelin dhe përgjegjësinë e detyrës e kanë parandaluar. Shtetasi rus ka



reaguar fizikisht, ka përdorur edhe një spray, që ka shkaktuar edhe lëndim, por, pavarësisht lëndimit, dy ushtarakët kanë njoftuar Policinë e Shtetit. Policia ka reaguar shumë shpejt dhe ka bërë të

mundur ndalimin dhe arrestimin e këtij shtetasi të huaj. Më pas, jo shumë larg nga uzina e Gramshit, janë ndaluar edhe dy shtetasit e tjerë, të cilët ndodheshin në një makinë. Padyshim që, e vendosur

edhe në kontekstin e gjerë rajonal edhe në kontekstin politik, duhet vlerësuar dhe nuk mund të kalojë si një incident i zakonshëm, por ne nuk mund të nxi-tohemi të nxjerrim konkluzione, por

gjithsesi fakti që është reaguar dhunshëm nga këta shtetas të huaj na bën të jemi më të vëmendshëm për ta hetuar deri në fund. Janë shumë struktura që do të punojnë që nga Inteligjenca jonë ushtarake, Policia Ushtarake, Shërbimi Informativ Shtetëror, Policia e Shtetit, Antiterrori. Tani janë në pyetje dhe hetim që të tre shtetasit e huaj që, siç e thashë, mbajnë pasaporta ruse dhe ukrainase”, - deklaroi z. Peleshi.

Ministri theksoi se ngjarje të tilla duhen trajtuar me përgjegjshmëri: “Është jonormale që ngjarje të tilla t'i trajtojmë sikur të ishte politika lokale e ditës. Sepse këto janë kritike sidomos edhe deklarime sidomos të faktorëve politikë, deklarime të institucioneve shtetërore vërehen, analizohen, komentohen dhe mund të kthehen edhe në një problem shumë më të madh se vetë ngjarja”, - tha z. Peleshi.

Niset Kontingjenti i 2-të me mision pranë KFOR-it, në Kosovë

Peleshi: Rritja e forcave të armatosura të vendeve aleate në Misionin e KFOR-it, kontribut i madh i Aleancës për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor

Kontingjenti i 2-të me 30 efektivë nga Forca Tokësore, efektivë të Batalionit Komando (nga Regjimenti i Operacioneve Speciale - ROS) janë nisur për në Kosovë për të shërbyer si pjesë e misionit të KFOR. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i pranishëm në ceremoninë e përcjelljes, e vlerësoi këtë si një moment të veçantë për faktin se këta efektivë nisen në mision si përfaqësues të vendit në përpjekjet e Aleancës së NATO për t'i shërbyer sigurisë dhe paqes. “Republika e Shqipërisë në vijimësi ka dëshmuar se është jo vetëm faktor paqeje dhe stabiliteti rajonal e më gjerë, por edhe një aleat serioz, i cili merr përsipër dhe mban barrën e detyrimeve dhe në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës”, - u shpreh gjatë fjalës së tij z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes theksoi mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë ndaj aspiratave të Kosovës, por vlerësoi edhe rritjen e pranisë së forcave të vendeve të Aleancës si pjesë e KFOR-it. “Mbështetja e Kosovës në aspiratat e saj kundrejt anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, duke kontribuar në forcimin e paqes dhe sigurisë, inkurajon zhvillimin e rajonit dhe frenon zgjerimin e influencës të vendeve të tjera, që sfidojnë demokracinë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sfidat tona të sigurisë mbeten të përbashkëta, të pandashme dhe të gjithanshme. Ato



vijnë nga çdo drejtim dhe mund të cenojnë sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë dhe më gjerë. Ministria e Mbrojtjes vlerëson dislokimin dhe rritjen e prezencës së forcave të armatosura të vendeve aleate dhe partnere në Misionin e KFOR-it. Ky është një kontribut i madh i Aleancës për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Siç e nënvizoi dhe sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, pak ditë më parë, trupat e

KFOR-it në Kosovë janë të gatshme dhe të vendosura për të ndjekur detyrën e tyre në përmbushje të misionit për të ruajtur një mjedis të sigurt në Kosovë dhe në rajon”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Peleshi vlerësoi edhe efektivët e Kontingjentit të Parë, të cilët sipas tij kanë treguar vlera dhe standarde të larta morale dhe, me profesionalizmin e tyre kanë fituar respektin dhe besi-

min e plotë të komandës të operacionit dhe efektivëve të tjerë të aleatëve të NATO-s.

30 trupat e Kontingjentit të 2-të nga Forca Tokësore, efektivë të Batalionit Komando (nga Regjimenti i Operacioneve Speciale - ROS) do të shërbejnë në zonën e Pejës, krah për krah me kolegët e tyre italianë dhe kroatë.

Në ceremoninë e përcjelljes morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, oficerë, nënoficerë si dhe familjarë të efektivëve.





Luiza Gega shpallet kampione e Europës në garën e 3000 metrave me pengesa

Kryeministri Rama: Luiza i dhuroi vendit imazhin e një Shqipërie që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve

Luiza Gega nuk di të ndalet, duke shkruar historinë për sportin shqiptar. Atletja, përfaqësuese e Forcave të Armatosura ka bërë një paraqitje fantastike në finalen e 3000 metrave me pengesa, duke u shpallur Kampione e Europës në aktivitetin e zhvilluar në Mynih.

Kampionia shqiptare shkoi në finale me kohën më të mirë të regjistruar në fazën kualifikuese dhe ishte pretendente kryesore për të fituar këtë garë. Këtë e tregoi më së miri duke diktuar ritmin dhe duke marrë kryesimin që pas 100 metrave të parë, për të lënë pas të gjithë rivalët që kërkonin t'i rrëmbenin nga duart një medalje që e ndiqte prej shumë kohësh.

Askush nuk mbajti ritmin fantastik të Luiza Gegës në këtë garë dhe sportistja shqiptare ia doli të kalonte finishin e vetme me kohën 9.11.31, që u bë rekordi i ri i Kampionatit European, duke thyer me 6 sekonda atë të vendosur në vitin 2010 nga rusja Zaripova.

Kryeministri Edi Rama, në pritjen e organizuar për nder të atletes tha:

“Luiza i dhuroi vendit imazhin e një Shqipërie që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve, nëse e shohim të gjithë rrugëtimin dhe vrapimin e Luizës deri kur ka zbritur në pistë për ato më pak se 10 minuta që tanimë i përkasin historisë, ato janë hapa të pafundmë sfilitje, gjaku, lotësh dhe djerse”.

Më tej kryeministri iu drejtua kampiones: “Fort e admiruar kampione, tanimë edhe e Europës! Është një krenari dhe privilegj shumë i



veçantë që të kemi sot këtu mes nesh në një përpjekje për të thënë faleminderit, jo doemos me të gjitha fjalët e nevojshme, edhe pse këtu u thanë shumë fjalë, por prapë kjo arritje të lë pa fjalë, por të paktën me të gjithë ceremonialin që ofron

shteti”, - iu drejtua Rama, kampiones së Europës në atletikë. “Sipërmarrja e saj është marramendëse, kur flasim dhe mendojmë që çfarë i dhuroi Luiza Shqipërisë, imazhin e një Shqipërie që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve. Është e pamundur të mos

e imagjinojmë se çfarë do të thotë kjo dhe është e pamundur të mos e shohim diferencën mes këtyre 4 fjalëve kaq të thjeshta dhe kaq të rënda dhe 400 milionë fjalëve të tjera të kota që konsumohen përditë dhe që nuk prodhojnë asnjë gjë,

gjak, sfilitje, lot dhe djerse”, - shtoi Rama. Kryeministri theksoi se: “fitorja madhështore me rekord të ri i Kampionatit European është edhe një dëshmi e vyer për të gjithë ne, sportistë e jo sportistë, të rinj apo më pak të rinj, për të gjithë brezat”.

Gjeneral brigade Arben Kingji priti ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Tayyar Kağan Atay

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një takim me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Tayyar Kağan Atay dhe atasheun ushtarak turk kolonel Muhamet Kelami Kablay.

Gjeneral brigade Kingji në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal, por edhe më tej, në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të përbashkëta dhe të NATO.

Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve shtrihet gjerësisht dhe përfshin fushat e edukimit dhe trajnimit, shëndetësore, modernizimin dhe mbështetjen logjistike.

Gjeneral brigade Kingji theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e Edukimit dhe Trajnimit të ushtarakëve të FARSH në kurset dhe akademitë turke, si një kontribut për zhvillimin e lidershipit.

Ndërsa në lidhje me modernizimin e FA-ve, asistenca turke ka qenë domethënëse në rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe modernizimin me pajisje luftarake të ndërveprueshme të reparteve të deklaruar në NATO.

Të dy bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e vazhimit të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve, sipas planeve të bashkëpunimit ushtarak bilateral si dhe atyre në kuadër të NATO-s dhe iniciativave rajonale.



Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve shtrihet gjerësisht dhe përfshin fushat e edukimit dhe trajnimit, shëndetësore, modernizimin dhe mbështetjen logjistike.
Gjeneral brigade Kingji theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e Edukimit dhe Trajnimit të ushtarakëve të FARSH në kurset dhe akademitë turke, si një kontribut për zhvillimin e lidershipit.

SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji, priti atasheun ushtarak të Gjermanisë, nënkolonel Dirk Weber, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në Tiranë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim përshëndetës atasheun ushtarak të Gjermanisë, nënkolonel Dirk Weber, në kuadër të përfundimit të mandatit të tij në Tiranë.

Gjeneral brigade Kingji, vlerësoi bashkëpunimin dhe marrëdhëniet ndërmjet Forcave të Armatosura të Gjermanisë dhe Shqipërisë, veçanërisht ato në fushën e arsimit dhe shprehur gatishmërinë për forcimin më tej të këtyre marrëdhënieve.

Nga ana e tij, nënkolonel Weber e falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, për mbështetjen e treguar gjatë kohës së qëndrimit të tij në detyrë, si dhe e siguroi atë se edhe pasardhësi i tij, nënkolonel Hans-Peter Wamsler, do të vijojë punën për



vijimin dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve.

Në përfundim të takimit, gjeneral brigade Kingji, duke i uruar suksese të mëte-

jshme, i akordoi nënkolonel Weber "Certifikatë Mirënjohje", duke i uruar në të njëjtën kohë mirëseardhjen nënkolonel Wamsler.



Forca **DETARE**

Në ambientet e Komandës së Forcës Detare u zhvillua vlerësimi teorik për vetëdrejtimin autonom të anijeve. Testimi teorik do të pasohet nga ai praktik. Ky moment është shumë i rëndësishëm për karrierën ushtarake pasi është pikënisja e një angazhimi të gjatë dhe marrje përgjegjësie për veten dhe efektivat që ata do të komandojnë.

Këta oficerë janë pjesa më vitale e Forcës Detare, pasi janë gjithmonë në vijën e parë në kryerjen e detyrave të tilla si dhënia e ndihmës ndaj njerëzve dhe mjeteve në rrezik.



Zhvillohet stërvitje e përbashkët trajnuese e palombarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Qendrës së Zhytjes

Për rreth 4 ditë u zhvillua një stërvitje trajnuese e përbashkët ndërmjet palombarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me palombarët e Qendrës së Zhytjes dhe Flotiljen Detare Pashaliman.

Gjatë këtij trajnimit u zhvilluan zhytje ambientuese deri në 3-12m, forma e kërkimit me mbështetje nga gomonia, orientim me busull dhe format e kërkimit me pamje kufizuese, eliminimi i pengesave gjatë kërkimit nën ujë.

Gjithë faza e trajnimit është realizuar me sukses dhe bashkëpunimi mes palombarëve të FSK-së dhe palombarët e Qendrës së Zhytjes dhe Flotiljes Detare do të vazhdojë edhe në të ardhmen në qëllim njohjen e pajisjeve dhe qendrave respektive.



Në ambientet e Komandës së Forcës Detare u zhvillua vlerësimi teorik për vetëdrejtimin autonom të anijeve

Forca **AJRORE**


Helikopteri EC - 135 në ndihmë të turistit italian

Ekuipazhi i helikopterit MEDEVAC EC - 135 ka kryer operacione fluturuese në një kohë të shpejtë, duke transportuar një pacient, turist italian, nga Syri i Kaltër, Theth drejt Spitalit të Traumës, në Tiranë, dhe më tej me dy misione tjera në ndihmë të pacientëve nga Bulqiza dhe nga Peshkopia në drejtim të QSUT, Tiranë.

Forca Ajrore, ngelet e gatshme për t'iu përgjigjur në çdo kohë dhe në çdo vend kërkesave në mbështetje të autoriteteve civile.



Miqësia është një marrëdhënie e një shkalle të lartë afërsie, e cila bazohet në besimin e thellë, dashurinë reciproke, interesat dhe pikëpamjet e përbashkëta. Një shok i vërtetë është i lidhur thellësisht me një mik, gjithmonë mund të mbështetet në ndihmën e ndërsjellë, të ofrojë mbështetje, të jetë besnik, i ndershëm me fjalë dhe vepra. Ka disa nga tiparet më të njohura të manifestimit të tij.



“Mos ecni pas meje, nuk mund t’ju udhëheq. Mos ecni para meje, unë nuk mund t’ju ndjek. Ecni pranë meje dhe jini miku im”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Jetojmë mes njerëzve, që shpesh për shkak të marrëdhënieve të krijuara i quajmë miq.

Por sa është e vërtetë kjo?

Sa e rëndësishme është të kesh një mik të vërtetë?

A ekziston miqësia?

Miqësia është një koncept shumë i gjithanshëm dhe kompleks. Çdo person në botë mund të japë përkufizime krejtësisht të ndryshme për këtë fjalë. Njerëzit kanë pasur miqësi që nga fillimi i kohës. Kur dikush është i rrethuar nga miqtë e tij të ngushtë, i duket se nuk është i vetëm në këtë botë, ka gjithmonë dikë për t’u mbështetur, i cili mund të ndihmojë në kohë të vështira me fjalë dhe me vepra, për të dëgjuar. Shokët janë gati të vijnë në ndihmë, ata qëndrojnë në anën e tyre edhe kur gabojnë. Shumë shpesh njerëzit ngatërrojnë përkufizimin e “miqësisë” me një lloj tjetër marrëdhënieje ndërpersonale, presin veprime dhe fjalë të tjera të pazakonta, gjë që shpesh çon në zhgënjim të ndërsjellë.

Çfarë është miqësia?

Miqësia është një marrëdhënie e një shkalle të lartë afërsie, e cila bazohet në besimin e thellë, dashurinë reciproke, interesat dhe pikëpamjet e përbashkëta. Një shok i vërtetë është i lidhur thellësisht me një mik, gjithmonë mund të mbështetet në ndihmën e ndërsjellë, të ofrojë mbështetje, të jetë besnik, i ndershëm me fjalë dhe vepra. Ka disa nga tiparet më të njohura të manifestimit të tij. Kuptimi i ndjesive, ndjenjave dhe nevojave të mikut.

Ndonjëherë ndjeshmëria mund të arrijë një ekstrem të tillë saqë njerëzit bëhen pothuajse identikë me qëndrime, mendime dhe ndjenja. Një perceptim i tillë jo vetëm që ndihmon për të njohur më mirë mikun tuaj, por gjithashtu sjell kënaqësi të madhe nga afërsia, ndjenjën e një shpirti të afërm në këtë Univers të pafund. Fjala “miqësi” ka kuptime të ndryshme për shumë njerëz. Kjo mund të varet nga sa afër personi dëshiron t’i lejojë njerëzit të hyjnë. Njëri është në gjendje të thërrasë pesëdhjetë të njohur miq të vërtetë, tjetri do t’i numërojë shokët e tij në gishtat e dorës. I treti do të thotë se fjalën “mik” ai nuk është në gjendje të thërrasë askënd. Në Greqinë e lashtë, ky koncept ndahej në dy, duke theksuar: miqësi, e cila bazohej në interesa të ndërsjella dhe qëllime të përbashkëta të ekipit; miqësia që quhej “fisnike” mund të lindte vetëm midis dy njerëzve si një lidhje e pastërtisë së lartë. Sot, më së shpeshti quhet gabimisht miqësi: komunikimi me miqtë. Sidoqoftë, dëshirat më të fshehta dhe nevojat më të thella të njerëzve të tillë, si rregull, nuk u besohen. Shprehja e solidaritetit dhe interesave të përbashkëta të ekipit.

Në ato marrëdhënie në të cilat nuk ka besim, sinjeritet dhe dashuri, koncepti i “miqësisë” thjesht nuk ka vend. “Miqësia e vërtetë është një nga ato gjëra për të cilat, si gjarpërinjtë gjigantë të detit, nuk dihet nëse janë të trilluar apo ekzistojnë diku”.

Miqësia mund të jetë kalimtare dhe të kalojë së bashku me këtë simpati. Ndonjëherë miqësia zgjat me vite dhe forcohet vazhdimisht gjatë kësaj kohe. Miqësia e vërtetë bazohet në besimin dhe ndihmën e ndërsjellë. Njerëzit që janë miq janë psikologjikisht të kënaqur me njëri-tjetrin. Shpesh miqtë janë emocionalisht më afër njëri-tjetrit sesa të afërmit.

Pavarësisht se si ndryshon shoqëria, gjithsesi, për miqësi janë mbeten vlera të përbashkëta që kanë rëndësi të madhe për njerëzit e të gjitha brezave, besimeve dhe kulturave. Një nga këto vlera të përbashkëta, sigurisht, është miqësia. Njerëzit e përdorin shumë shpesh këtë fjalë në fjalorin e tyre, ata i quajnë disa njerëz miq, por pak njerëz mund të formulojnë se çfarë është miqësia, kush është një mik i vërtetë, çfarë duhet të jetë. Fatkeqësisht, unë nuk bëj përjashtim. Dhe është e vështirë për mua të përcaktoj se çfarë është miqësia. Por mendoj se kjo duhet sqaruar njëherë e mirë, sepse është e rëndësishme, para së gjithash, për veten.

Tani shumë nuk dallojnë miq dhe të njohur të vërtetë.



Moshatarët e mi ndonjëherë priren t’i thërrasin njerëzit me të cilët janë më miq; ata thjesht argëtohen, ndonjëherë të rriturit i quajnë kolegët e tyre miq me të cilët ndonjëherë komunikojnë jashtë zyrës. Nuk mendoj se është miqësi, është thjesht një lloj marrëdhënieje mes njerëzve. Me kalimin e kohës, një “miqësi” e tillë do të zhduket vetvetiu, dhe për këtë arsye as nuk do të bëhet e vetmuar, madje mund të mos e vini re. Unë besoj se miqësia nuk varet nga mosha, statusi shoqëror, pasuria materiale. Gjithashtu, nuk ndahet në mashkull dhe femër. Në përgjithësi, dëgjon shumë mendime për faktin se ka miqësi femërore, ka miqësi midis një burri dhe një gruaje. Sa për mua, natyrisht, gratë i ndërtojnë marrëdhëniet e tyre në një mënyrë krejtësisht të ndryshme nga burrat, kështu që “miqësia” e tyre nuk është absolutisht si ajo e burrave, por kjo nuk do të thotë se miqësia midis tyre nuk ekziston. Thjesht mënyra e miqësisë dhe pikëpamjet për miqësinë janë po aq të ndryshme sa njerëzit të ndryshëm ka në botë. Ata thonë se miqësia është dashuri që i ka krahët e prerë. Por unë besoj se edhe miqësia ka krahët e saj, ato janë thjesht një ngjyrë tjetër...

Edhe pas shumë vitesh, pasi jeta ka menduar mirë të ndajë rrugët e dy njerëzve, shohim një mik dhe duket se koha ndalet, e tillë është forca dhe lidhja që miqësia ka ruajtur me kalimin e kohës. Kjo është një masë që flet për një ndjenjë unike, ndryshe nga dashuria, por absolutisht jo inferiore, ose më pak intensive. Miqësia është motori i një marrëdhënieje të bazuar në reciprocitet, disponueshmëri, ndarje, përkrahje, dashuri dhe besim. Për këtë arsye ndryshe nga dashuria, dhe absolutisht ndryshe nga dija normale. Ato që karakterizojnë gjithnjë e më shumë marrëdhëniet midis njerëzve

Përkrahja, ndarja, barazia karakterizojnë dhe mbështesin këtë ndjenjë që, për këtë arsye, arrin të ruajë pastërtinë e saj me kalimin e kohës.

Nuk ka xhelozji për t’u prishur, qëllime për të pushtuar, por vetëm kënaqësi dhe përkushtim, që të jenë unike për dikë. Një mik nuk ka frikë të thotë atë që mendon se e di që shpreh mendimin e tij jo për një interes personal. Një mik është ai që ka forcën dhe

qetësinë për të thënë gjëra të pakëndshme, duke e ditur plotësisht se ai nuk e shfrytëzon këtë qëndrim. Një miqësi e vërtetë dhe e thellë bazohet në atë që quhet një e mirë joracionale.

Një ndjenjë që nuk ka ambicie ose objektiva siç ndodh shpesh në një marrëdhënie në çift dhe prandaj është në gjendje jo vetëm të përballojë lotët e kohës dhe të distancës, por edhe të stuhive që mund të kalojnë këto marrëdhënie. Dallimi, në krahasim me marrëdhëniet e tjera, është diçka e vështirë për t’u definuar, një lidhje intime dhe e thellë që lidh dhe bashkon, pavarësisht suksesve apo humbjeve, lotëve ose buzëqeshjeve.

Këto janë momente në të cilat miqësia tregon karakterin e saj, durimin, aftësinë për të rezistuar dhe ndikuar në jetën e dy njerëzve. Miqësia, kur është e vërtetë, nuk ka sekrete, nuk ka nevojë për trillime. Miku nuk gjykon, nuk konkurren dhe mbi të gjitha nuk tradhton. Miku është gjithmonë aty, edhe në largësi. Për të treguar se së bashku, mund të ndani jetën.

E tillë është miqësia sipas konceptit tim, ose kështu unë e perceptoj si ndjesi.

Por, a ka miqësi sot në këtë botë të trazuar?

Në çdo kohë, miqësia në përgjithësi konsiderohej vlera më e lartë morale. Megjithatë, në kushte të ndryshme historike, themelet e saj morale, rëndësia e saj sociale, mundësitë për zhvillimin e saj ishin të ndryshme. Në çdo shoqëri ka shumë kufizime për zhvillimin e miqësisë, një njeri që jetonte në epokën e skllavërisë, se lejonte mendimin e miqësisë midis lirisë dhe skllavërve. Socializmi, duke eliminuar pronën private dhe marrëdhëniet e dominimit dhe të nënshtrimit, krijoi kushte të favorshme për zhvillimin e miqësisë. Në fund të fundit, pabarazia që ekzistonte më herët, armiqësia midis njerëzve ishte një pengesë për shfaqjen e miqësisë, e cila minoi themelet e saj.

Në shoqërinë e zhvilluar socialiste, krijohen gjithnjë e më shumë kushte për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore. Por kjo nuk do të thotë se në vendin tonë, miqësia mund të lindë midis çdo populli që të gjithë mund të jenë mik.

Filozofi Ciceron ka thënë: **“Miqësia është e mundur vetëm midis njerëzve të ndershëm...”**, dhe kjo vlen për çdo kohë.



Gjatë qëndrimit në zonat shqiptare, gjeneral Tellini u prit si mik dhe u respektua për punën që po bënte. Shpesh i shoqëruar nga delegati shqiptar dhe nga anëtarë të tjerë të komisionit, ai bëri vizita në fshatrat shqiptare. Banorët sa herë që e takonin në rrugët e Korçës, në koncertet e Bandës Kombëtare “Vatra” apo në kinema “Modern”, ku shëtiste lirisht, e përshëndesnin me gëzim e dashuri të dukshme.



Gjenerali i misioneve ndërkombëtare



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
MJESHTËR I MADH

Vendimi për kufijtë jugorë të Shqipërisë

Caktimi i kufijve të Shqipërisë u bë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Më 22 mars 1913 u vendosën përfundimisht kufijtë veriorë dhe në qershor-gusht 1913 u morën vendimet për kufijtë jugorë. Konferenca e Ambasadorëve krijoi dy komisione ndërkombëtare: njërin për kufijtë me Malin e Zi e Serbinë dhe tjetrin për kufirin me Greqinë. Gjatë punës në terren komisionet, sidomos ai i jugut, hasën në vështirësi të mëdha deri në paralizimin e punës. Për këtë u propozua fuqive të Mëdha një vijë e re kufiri, e cila u vendos në Firence, ku Komisioni hartoi, më 17 dhjetor 1913, protokollin mbi kufijtë jugorë e juglindorë të Shqipërisë, të cilët, me disa ndryshime të vogla, janë po ato që ekzistojnë edhe sot.

Kjo padrejtësi historike ndaj një prej popujve më të vjetër të Europës, do të sillte ndeshje, gjak, mëri, dhunë dhe lot deri në fillimin e shek. XXI. E drejta vonon, por s'mungon, shqiptarët, të drobitur nga luftërat dhe të tradhtuar, vendosën t'i zgjidhin vetë problemet, duke vënë para faktit të kryer fuqitë e Mëdha. Lufta e Vlorës, Kongresi i Lushnjës etj., sollën pranimin e Shqipërisë, më 17 dhjetor 1920, në Lidhjen e Kombeve. Në këto kushte më në fund, Konferenca e Ambasadorëve në Paris, më 9 nëntor 1921, vendosi që kufijtë shqiptaro-grekë të mbeteshin po ato të caktuara nga Protokollin i Firences, kurse për kufijtë verilindorë bëri përsëri ndryshime në favor të Jugosllavisë. Për caktimin e këtyre kufijve konkretisht në vend, u la të formohej një komision, me përfaqësues të Anglisë, Francës, Italisë dhe Japonisë, i cili u krijua më 8 janar 1922. Në të merrnin pjesë përfaqësuesi i Italisë Gjeneral Enriko Tellini, i Anglisë kolonel Gilles, i Francës kolonel Ordion, dhe kapiten De Limperani që ishte sekretar i përgjithshëm i komisionit. Japonia nuk dërgoi delegatin e saj. Kryetar i komisionit u caktua Gjeneral Enriko Tellini, dhe jo rastësisht.

Gjeneral Tellini (Enrico Tellini) kishte lindur më 25 gusht 1871 në Kastelnuovo të Garfanjanës. Ai kishte marrë pjesë në luftën italo-turke dhe në Luftën e Parë Botërore. Për zotësinë e disiplinën e lartë arriti të marrë gradën e gjeneralit të brigadës pas shërbimit si kolonel i Shtatmadhorisë. Pranë komisionit do të punonte dhe një komitet tekniko-gjeografik. Shtetet e interesuara për kufijtë Shqipëria, Greqia dhe Jugosllavia do të kishin përfaqësuesit e tyre pranë komisionit. Përfaqësuesi i Shqipërisë në fillim u caktua Bajram Fevziu, i cili më pas u zëvendësua nga Dhimitër Berati, sekretar i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Komisioni erdhi në Shqipëri në mars 1922 dhe filloi punimet në zonën kufitare nga mali Gramoz deri në pikën e kufirit greko-shqiptaro-jugosllav, për të vazhduar pastaj për më në jug.

Për një bashkëpunim të sinqertë

Komisioni ndeshi në pengesa të mëdha nga delegacioni grek. Në një raport të gjeneral Tellinit thuhet se: “Ky delegacion, nuk më jep besim për një bashkëpunim të sinqertë. Delegacioni kërkon me të gjitha mjetet dhe pretekstet për t'u larguar... Autoritetet dhe trupat greke nxjerrin pengesa nga më të ndryshmet”. Në nëntor, për shkak të këtyre pengesave dhe dimrit që po afronte, Konferenca e Ambasadorëve vendosi që punimet e caktimit të kufijve të rifillonin më 1 maj 1923. Gjeneral Tellini, gjatë punës së tij, u përpoq të ishte i paanshëm në marrjen e vendimeve; sipas rastit, ai nuk kurseu as shqiptarët, as grekët, as jugosllavët. Në raportin e fundit drejtuar Konferencës së Ambasadorëve, më 26 gusht 1923, pikërisht një ditë para vrasjes, gjeneral Tellini shprehet se: “... vendimet e komisionit janë të paanshme... dhe ai po kryen detyrën e tij duke u bazuar në ndërgjegjen e vet e drejtësinë”.

Gjatë qëndrimit në zonat shqiptare, gjeneral Tellini u prit si mik dhe u respektua për punën që po bënte. Shpesh i shoqëruar nga delegati shqiptar dhe nga anëtarë të tjerë të komisionit, ai bëri vizita në fshatrat shqiptare. Banorët sa herë që e takonin në



rrugët e Korçës, në koncertet e Bandës Kombëtare “Vatra” apo në kinema “Modern”, ku shëtiste lirisht, e përshëndesnin me gëzim e dashuri të dukshme. Krejt e kundërta ndodhte në shtetin fqinj, ku ndaj punës së komisionit kishte një qëndrim agresiv e sabotues. Sipas një raporti të Konsullatës italiane në Janinë, gjatë një diskutimi në një moment rrëmbimi, përfaqësuesi grek kishte thënë për gjeneral Tellinin “duhet vrarë”. Këtë frazë ky kolonel e ka përsëritur edhe në një lokal publik. Më 27 gusht 1923 komisioni i kufirit do të shkonte nga Janina në Kakavijë, ku do të përfundonte vendosjen e disa gurëve kufitarë atje. Herët në mëngjes, u nisën nga Janina automobilat e delegatëve shqiptarë, grekë e italianë. Automobili i përfaqësuesve grekë pësoi një “defekt”. Automobili i italianëve parakaloi atë grek, duke ndjekur automobilin shqiptar. Gjeneral Tellini ishte 30 minuta larg përfaqësive shqiptare. Pasi kaloi automobili i komisionit shqiptar, në afërsi të Janinës, në vendin e quajtur Zepe (54-55 km larg Janinës), 4 km larg Delvikanit dhe 10 km larg kufirit shqiptar, midis Delvikanit dhe Arnishtes, rruga ishte e bllokuar me drurë të mëdhenj. Vendi i zgjedhur ishte shumë i përshtatshëm për pusi, në bërnylin e një kthese. Kur arriti automobili i gjeneralit, shoferi Renixho Farneti dhe përkthyesi shqiptar Thanasi Kraveri (Leskoviku), zbritën për të larguar drurët nga rruga, por u qëlluan prej personave që kishin zënë pusi dhe mbetën të vdekur që të dy. U vra dhe doktori Luixhi Korti që ndodhej brenda në makinë. Adjutanti Mario Bonacini sapo doli prej automobilin, u plagos rëndë e mbeti nën të. Gjenerali u hodh nga makina dhe pasi u largua rreth 20 m mbeti i vrarë me revolver në dorë. Delegati shqiptar, i mbështetur nga dr. Xhioi (i Institutit Gjeografik italian), kërkoi sërish që të shkonte në ndihmë të gjeneral Tellinit, por përsëri nuk u lejua një gjë e tillë. Trupat ishin transportuar në Janinë e në vendin e ngjarjes kishin mbetur vetëm disa gjurmë gjaku.

Për nder të tyre në Janinë u dha një meshë dhe trupat e italianëve të vrarë, me nderimet e duhura u nisën në Prevezë, në kishën katolike. Edhe këtu u dha një meshë. Në ora 12.30 të datës 19 shtator 1923, trupat e tyre u nisën në mënyrë ceremoniale për në Taranto të Italisë me avulloren San Marko. Ceremonia zyrtare u bë në kishën Santi Apostoli në Romë, ku morën pjesë Duka i Aostës, Duka i Gjenovës, Konti i Torinos, Princi i Udines, Musolini me ministrat, të gjithë ambasadorët dhe përfaqësues të tjerë të huaj. Pastaj trupat u dërguan secili për në vendin e lindjes. Gjeneral Tellini u varros në Firence. Më 8 shtator 1923, Konferenca e Ambasadorëve vendosi të dërgojë në Janinë një komision special hetimi, i cili nuk mundi të japë një mendim përfundimtar të saktë rreth përgjegjësisë që çuan në atentatin e 27 gushtit. Vrasja e komisionit italian shkaktoi krizë në marrëdhëniet italo-greke. Qeveria italiane bëri përgjegjëse palën greke dhe kërkoi dëmshpërblim për këtë vrasje. Kjo krizë solli edhe pushtimin e përkohshëm të Korfuzit nga ana e italianëve. Kush ishte vrasësi i misionit Italian? Komisioni i hetimit nuk dha përfundime.

Por një gjë ishte e sigurt, krimi u krye për motive politike. Autorë të tij ishin ato forca, të cilave u prishte punë korrektësia dhe paanësia e gjeneral Tellinit dhe delegacionit italian.


Mirënjohja shqiptare

Kjo vrasje shkaktoi një reagim të fortë në Shqipëri. Opinioni publik shqiptar i konsideroi viktimat “theror për të drejtat ndërkombëtare”. Parlamenti shqiptar në shenjë zie ndërpreu punimet e tij për 24 orë. Autoritetet më të larta shqiptare i dërguan telegrame ngushëllimi personaliteteve italiane dhe familjeve të viktimave. Telegramet dërguan dhe bashkitë dhe populli i të gjitha qyteteve shqiptare. Në Korçë, në kishën e Shën Gjergjit, u bë një përshpirtje për gjeneralin e shokët e tij, ku merrnin pjesë autoritetet më të larta të qytetit. Populli i Vlorës ditën e 3 shtatorit, kur do të përkujtonte me festime 3-vjetorin e çlirimit të qytetit nga forcat italiane, vendosi të shfaqë hidhërimin e tij për vrasjen çnjerëzore me anë manifestimesh. Manifestuesit që arrinin në 3-4 mijë vetë u drejtuan në konsullatën italiane ku i shprehën ngushëllimet konsullit italian. Që andej vajtën në kishën katolike ku u bë një përshpirtje. Po ashtu në Tiranë, në kishën katolike, në atë ortodokse dhe në xhami u kryen gjithashtu shërbesa fetare për shpirtin e të ndjerëve të komisionit Italian.

Gazeta e Korçës, më 1 shtator 1923, e vlerëson kështu gjeneral Tellinin: “Emri i tij do të mbetet i paharruar për popullin shqiptar. Historia e rilindjes tonë kombëtare, emrin e këtij gjenerali të nderuar, së bashku me atë të kolonel Tomson, do ta përmendë me një nderim të madh, për shërbimet q'i solli Kombit tonë të shumëvujtur”. Gazeta “Vatra Shqiptare” do të shkruante: “Gjeneral Tellini për ne përfaqëson, njëkohësisht idenë e drejtësisë dhe atë të mbrojtjes të interesave tona”.

Për vlerësim dhe nderim të veprës së Gjeneral Enriko Tellinit, më 1933 në qendër të Tiranës, qeveria shqiptare emërtoi një rrugë të re “Rruga Gjeneral Enriko Tellini” dhe në krye të saj vendosi bustin e Tellinit, i bërë nga skulptori Odhise Paskali, te sheshi ku sot është Akademia e Shkencave, në vitin 1941. Gjenerali italian Enriko Tellini që ka dhënë kontribut unikal në historinë e Shqipërisë. Ai gjithmonë do të përkujtohet dhe do të nderohet nga shqiptarët.

Libri i autorit italian Andrea Giannasi, “Vrasja Tellini” (Nga Janina deri në pushtimin e Korfuzit gusht-shtator 1923), është në shqip, i përkthyer nga Kolonel (R) Guri Pashaj. Ushtaraku i lartë italian u vra gati 99 vjet më parë, në krye të detyrës për zbatimin e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës. Një ditë para vrasjes, gjeneral Tellini shprehet se: “... vendimet e komisionit janë të paanshme... dhe ...ai po kryen detyrën e tij duke u bazuar në ndërgjegjen e vet e drejtësinë”. Për figurën dhe veprën e Gjeneral Tellinit është shkruar në shumë enciklopedi të botës, është ruajtur në memorien historike të popullit shqiptar.



Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

"Ju jeni një frymëzim për botën!"

Mesazh i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Ditën e Pavarësisë së Ukrainës

Në luftë, në zi dhe në vuajtje, por me një vullnet të fuqishëm, gjashtë muaj pas agresionit të Rusisë, Ukraina festoi Ditën e Pavarësisë, 24 gushtin, që këtë herë, kjo datë ishte krejt e veçantë, pasi Ukraina po gjakoset, po vuan, por po qëndron në këmbë me një forcë të hekurt.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përcolli, më 24 gusht 2022, një video-mesazh mbështetjeje për popullin e Ukrainës, teksa ajo shënoi Ditën e Pavarësisë. Gjashtë muaj pas fillimit të pushtimit ilegal të Ukrainës nga Rusia, Stoltenberg tha se "Lufta e Rusisë në Ukrainë është kriza më e madhe për sigurinë e Europës që nga Lufta e Dytë Botërore. Forcat e armatosura të Ukrainës dhe i gjithë populli ukrainas po tregojnë guxim dhe vendosmëri të jashtëzakonshme. Dhe, nën udhëheqjen e Presidentit Zelenskyy, ju jeni një frymëzim për botën."

Ukraina duhet të mbizotërojë dhe Ukraina do të mbizotërojë

"Të dashur ukrainas, të dashur miq, Poeti juaj i madh, Taras Shevchenko, shkroi se: 'Kjo ka një ndryshim të madh për mua/ Ai popull i lig dhe njerëz të ligj/ Sulmuan Ukrainën tonë, dikur kaq e lirë/ E grabisin dhe plaçkisin atë sipas dëshirës/ Ka një ndryshim të madh për mua', nisi video-mesazhin e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg drejtuar popullit ukrainas në Ditën e Pavarësisë së vendit të tyre.

"Kjo bën një ndryshim të madh edhe për NATO-n. Lufta e Rusisë në Ukrainë është kriza më e madhe për sigurinë e Europës që nga Lufta e Dytë Botërore. Forcat e armatosura të Ukrainës dhe i gjithë populli ukrainas po tregojnë guxim dhe vendosmëri të jashtëzakonshme dhe nën udhëheqjen e Presidentit Zelenskyy, ju jeni një frymëzim për botën. I bëj nderime të gjithë atyre që kanë humbur jetën apo janë plagosur dhe të gjithë burrave dhe grave ukrainase që po luftojnë për vendin e tyre, lirinë dhe të dashurit e tyre. NATO dhe aleatët e kanë mbështetur Ukrainën që kur vendi juaj fitoi pavarësinë. Ne e rritëm mbështetjen tonë pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe ne kemi bërë më shumë se kurrë që nga fillimi i pushtimit të Rusisë. Ju mund të vazhdoni të mbështeteni në mbështetjen e NATO-s. Për aq kohë sa duhet.

Siç e bënë të qartë liderët e NATO-s në Samitin tonë të Madridit, një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për stabilitetin e zonës euroatlantike. Ukraina duhet të mbizotërojë dhe Ukraina do të mbizotërojë. Në ditën e Pavarësisë, ju uroj forcë dhe sukses!", - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në video-mesazhin e tij drejtuar popullit ukrainas në Ditën e Pavarësisë së Ukrainës.

Dita e Pavarësisë së Ukrainës dhe sulmet vdekjeprurëse me raketa

Dita e Pavarësisë së Ukrainës, e cila, më 24 gusht 2022, shënoi 31-vjetorin kur vendi votoi për shkëputjen nga Bashkimi Sovjetik, ka qenë më e zymtë këtë vit. Dita u errësua nga një sulm me raketa në një stacion treni në lindje të Ukrainës, i cili vrau të paktën 22 njerëz, duke përmbushur paralajmërimet e zyrtarëve ukrainas. Ndërsa vitet e mëparshme janë shënuar me festime dhe parada, përkujtimi i këtij 24 gushti vjen saktësisht gjashtë muaj pas fillimit të pushtimit rus të vendit.

Ndërkohë Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelensky e shënoi ditën me një fjalim emocional që fliste për pushtimin rus dhe ditën e re të pavarësisë, ditën kur Ukrainës iu desh të luftonte për lirinë e saj,



në vend që thjesht të votonte për të në kutinë e votimit. "Ne po u qëndrojmë sulmeve për gjashtë muaj. Është e vështirë, por ne shtrënguam grushtat duke luftuar për fatin tonë. Çdo ditë e re është një arsye e re për të mos u dorëzuar. Sepse, duke kaluar kaq shumë, nuk kemi të drejtë të mos arrijmë në fund. Cili është fundi i luftës për ne? Thoshim: paqe, tani themi: fitore. Ne nuk do të presim mirëkuptim nga terroristët. Edhe pse e kuptojmë gjuhën ruse që erdhët për të mbrojtur. Dhe vratë mijëra njerëz që erdhët për t'i çliruar. Boris Johnson, i cili flet anglisht, është shumë më i kuptueshëm dhe më i afërt për ne sesa vrasësit, përdhunuesit dhe grabitësit, që e bënë atë në rusisht. Dhe ne nuk ulemi në tryezën e bisedimeve nga frika, me armën e drejtuar në kokë. Për ne, hekuri më i tmerrshëm nuk janë raketat, avionët dhe tanket, por prangat. Jo llogoret, por zinxhirët", - tha presidenti Zelenskyy". Duke folur në një fjalim të regjistruar nga Sheshi i Pavarësisë së Kievit, presidenti Zelenskyy tha se Ukraina do të luftojë për sovranitetin e saj deri në fund.

Presidenti Volodymyr Zelenskyy dhe zonja e parë Olena Zelenska vendosën lule në një memorial kushtuar ushtarëve ukrainas të vrarë në Donbas. Në të gjithë vendin, ukrainasit bënë homazhe për ata që janë vrarë në aksionet ushtarake që nga fillimi i pushtimit. Udhëheqësit e huaj, vizituan gjithashtu Kievin. Festimet publike për ditën e pavarësisë u ndaluan në Kiev pasi udhëheqësit ukrainas dhe amerikanë paralajmëruan për rritjen e përpjekjeve ruse për të goditur infrastrukturën civile dhe objektet qeveritare në Ukrainë.

Festimet e fundit historike, në Ditën e Pavarësisë së Ukrainës

Dita e Pavarësisë së Ukrainës është festa kryesore shtetërore në Ukrainën moderne, e festuar më 24 gusht në përkujtim të

Deklaratës së Pavarësisë të vitit 1991. Kur Ukraina ishte ende një Republikë Sovjetike, diaspora ukrainase tradicionalisht e njohu 22 janarin (Shpalljen e Pavarësisë së Republikës Popullore të Ukrainës në 1918 si Ditën e Pavarësisë së Ukrainës. Forma aktuale e festës u festua për herë të parë më 16 korrik 1991, si përvjetori i parë i Deklaratës së Sovranitetit Shtetëror të Ukrainës miratuar nga Verkhovna Rada (parlamenti i Ukrainës) në 1990. Meqenëse Deklarata e Pavarësisë u lëshua më 24 gusht 1991 dhe u konfirmua me referendumin e 1 dhjetorit 1991, data e festës u ndryshua. Dita e Flamurit Kombëtar, duke filluar nga viti 2004, 23 gushti festohet si Dita e Flamurit Kombëtar.

Në përgjithësi (por jo çdo vit) dita e pavarësisë është festuar me një paradë ushtarake të mbajtur në Kiev, kryeqyteti i Ukrainës, por që nga viti 2019 nuk është zhvilluar asnjë paradë ushtarake. Sipas një dekreti të 21 tetorit 2020 të Presidentit Volodymyr Zelenskyy në vitin 2021 do të mbahej një paradë ushtarake (përsëri) me rastin e 30-vjetorit të Pavarësisë së Ukrainës.

Në 1997: Parada e Aviacionit Chayka ishte një shfaqje aviacioni në shkallë të gjerë kushtuar Ditës së Pavarësisë që u zhvillua në aeroportin e Kievit Chaika në vitin 1997. Ajo përmbante fluturime nga personeli i Forcave Ajrore të Ukrainës. Në paradë morën pjesë Presidenti i Ukrainës Leonid Kuchma dhe ministri i Mbrojtjes Oleksandr Kuzmuk.

Në 2016: Pas paradës ushtarake vjetore në Kiev, "Marshi i të Papshtuarve" u mbajt nga anëtarë aktivë të batalioneve vullnetare të Ukrainës, të afërm të të vrarëve gjatë luftimeve në Luftën Ruso-Ukrainase dhe anëtarë të familjeve të atyre që u vranë gjatë kryengritjes së Euromaidanit, të njohur në Ukrainë si "Njëqinda Qiellore". Sipas ushtrisë ukrainase, vëllimi i zjarrit të artillerisë i nisur



nga forcat separatiste të luftës në Donbas gjatë periudhës 24-orëshe të 24 gushtit 2016 ishte më i larti që nga Beteja e Debaltseve e shkurtit 2015. Disa qytete të Ukrainës zhvilluan marshime, ku pjesëmarrësit ishin të veshur me vyshyvanky (këmisha me qëndisje tradicionale ukrainase).

2019: Më 10 korrik 2019, presidenti Volodymyr Zelenskyy njoftoi në Facebook se festimet e Ditës së Pavarësisë së Ukrainës 2019 nuk do të përfshijnë një paradë ushtarake (për herë të parë që nga anulimi i paradës nga viti 2010 deri në 2014) duke thënë se: "Ne kemi vendosur të ndajmë 300 mln hryvnias (gati 12 milionë dollarë) si pagesa bonus për ushtarakët tanë, d.m.th., ushtarët me afat të caktuar, kadetët, rreshterët, oficerët". Zelenskyy përmendi gjithashtu se qeveria do të ndërmerre hapa për të "nderuar heronjtë" në Ditën e Pavarësisë duke nënvizuar faktin. se "formati do të jetë i ri". Më 30 korrik, Kreu i Administratës Presidenciale të Zelenskyy, Andriy Bohdan njoftoi se do të zhvillohet një Marsh i Dinjitetit në zëvendësim të paradës vjetore. Një marshim i veçantë, i njohur si Marshi i Mbrojtësve ishte planifikuar gjithashtu të mbahej nga veteranët ukrainas të luftës dhe dhënia e çmimeve të veteranëve. Gjatë fjalimit të tij, Zelenskyy bëri thirrje për unitet, dhe tha se: "Ukrainas-folës dhe rusisht-folës, pavarësisht nga mosha, gjinia, feja, ne duhet të jemi një popull".

Në 2020: Në Ditën e Pavarësisë në 2020, Presidenti Zelenskyy gjatë fjalimit të tij deklaroi se nuk do të ketë kurrë pajisje ushtarake në paradë në Kiev për sa kohë që lufta në Donbas vazhonte, gjatë së cilës ai tha se është "aty ku duhet tani". Zelensky deklaroi se parada ushtarake do të mbahen në të ardhmen "një paradë e fitores së Ukrainës, kur ne do të kthejmë të gjithë njerëzit tanë dhe të gjitha territoret tona". Ceremonia, si dhe koncerti që pasoi, u mbajtën në Mykhailivska. Sheshi përballë Manastirit

me Kupolë të Artë të Shën Mëhillit, selia aktuale e Kishës Ortodokse të Ukrainës, dhe në këtë mënyrë nderoi punonjësit mjekësorë dhe profesionistët ukrainas që kishin kontribuar në përpjekjet e tyre gjatë pandemisë aktuale COVID-19 në të gjithë Ukrainën.

Koncerti i përbashkët i yjeve ukrainas pas ceremonisë u shënu nga skandali sepse artistë të ndryshëm që performonin në të kishin vazhduar të performonin dhe/ose të merrnin çmime në Rusi, pavarësisht se Republika Autonome Ukrainase e Krimesë u aneksua nga Rusia në 2014 dhe supozimi i mbështetjes së Rusisë, për forcat separatiste të luftës në Donbas. Gjithashtu u dënua që ky koncert u mbajt gjatë Marshit të Mbrojtësve në përkujtim të viktimave të luftës në Donbas.

Në një fjalim në gjuhën angleze të Ditës së Pavarësisë, Zelenskyy nisi një fushatë informacioni për të rifilluar markën Ukraine NOW. Ngjarjet e vitit 2020 shërbyen si një nisje kombëtare për festimet në 2021 duke shënuar vitin jubilar perla të pavarësisë.

Në 2021: Në vitin 2021, Ukraina festoi 30-vjetorin e pavarësisë së saj me tre ditë ngjarje. Një kompani nga Lviv zhvilloi një logo të veçantë të 30-vjetorit dhe u shpall një çmim i ri i njohur si "Legjenda Kombëtare", që do të prezantohej në një ceremoni më 22 gusht. Gjithashtu u njoftua se Samiti i parë i Platformës së Krimesë do të mbahej më 23 gusht. Një numër liderësh të huaj ishin të ftuar në festimet e 30-vjetorit, duke përfshirë presidentin e SHBA-ve Joe Biden, presidenten greke Katerina Sakellariopoulou, presidentin lituanëz Gitanas Nauseda dhe presidenten moldave Maia Sandu.

Më 24 gusht, një paradë e madhe ushtarake kaloi përmes Kievit, duke kaluar Maidan Nezalezhnosti, duke shfaqur Forcat Tokësore të Ukrainës, Forcat e Operacioneve Speciale dhe njësitë e vizituara nga disa forca të armatosura të huaja. Parada përfshinte më shumë se 5000 trupa dhe 400 tanke dhe automjete të blinduara. Veprimtaria përfshinte gjithashtu një fluturim të njësisë të Forcave Ajrore të Ukrainës mbi Kiev. Njëkohësisht, njësitë e marinës ukrainase u shfaqën duke kryer stërvitje në Odessa. Trupat vizituese nga Sllovenia, Moldavia, Polonia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadaja marshuan me forcat ukrainase, dhe dy Typhoon Eurofighter të Forcave Ajrore Mbretërore Britanike morën pjesë në fluturim së bashku me katër F-16 Fighting Falcons.

Morën pjesë delegatë nga 46 vende, duke përfshirë presidentin polak Andrzej Duda, presidentin lituanëz Gitanas Nauseda dhe ministrin e Jashtëm francez Jean-Yves Le Drian dhe patriarkun e Kishës Ortodokse Lindore Bartolomeu I i Konstandinopojës. Menjëherë para paradës, Presidenti Zelenskyy iu drejtua turmës, duke bërë thirrje për marrëdhënie më të ngushta me vendet e tjera ish-sovjetike, vendet europiane dhe NATO-n.

KRYETARI I KOMITETIT USHTARAK TË NATO-S SHËNON DITËN E PAVARËSISË SË UKRAINËS



Ukraina mund ta fitojë këtë luftë dhe të dalë fitimtare

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Rob Bauer nderoi guximin dhe sakrificën e Forcave të Armatosura të Ukrainës në një videomesazh për të shënuar Ditën e Pavarësisë së Ukrainës.

Ai përshëndeti burrat dhe uniformat që kanë ndryshuar rrënjësisht luftën moderne dhe e kanë tejkaluar kundërshtarin e tyre herë pas here. Ukraina mund ta fitojë këtë luftë dhe të dalë fitimtare nga moçali. Lavdi Ukrainës!"



PLATFORMA E KRIMESË

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s thekson mbështetjen afatgjatë të Aleancës për Ukrainën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mori pjesë me Presidentin Volodymyr Zelenskyy dhe liderë të tjerë botërorë në Samitin online të Platformës Ndërkombëtare të Krimesë, më 23 gusht 2022. Ai detajoi mbështetjen e fortë që NATO dhe aleatët po i japin Ukrainës.

Stoltenberg tha se: “Ukraina ka vuajtur gjashtë muaj të tmerrshëm lufte, por ju keni treguar gjithashtu aftësinë tuaj të pabesueshme për t’i rezistuar agresionit brutal, për të goditur, rimarrë territorin dhe për t’i imponuar Rusisë kosto të mëdha. NATO qëndron në solidaritet të plotë me Ukrainën. Aleatët mbështesin plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, të drejtën tuaj për vetëmbrojtje dhe për të zgjedhur rrugën tuaj.” Aleatët e NATO-s kanë ofruar ndihmë të paprecedentë ushtarake, financiare dhe humanitare për Ukrainën. Sekretari i Përgjithshëm kujtoi se: “NATO-ja e rriti ndjeshëm mbështetjen te saj pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë, kështu që kur Rusia pushtoi përsëri, më 24 shkurt, kjo ndihmoi që forcat e armatosura ukrainase të bëhen më të forta, më të trajnuara dhe të udhëhequra më mirë se në 2014”. Në Samitin e Madridit në qershor, udhëheqësit e NATO-s ranë dakord për një paketë të forcuar ndihme duke përfshirë karburantin, ushqimin, furnizimet mjekësore pajisje mbrojtëse ushtarake dhe komunikime të sigurta, si dhe pajisje për të luftuar minat, dronët, kërcënimet kimike dhe biologjike. Stoltenberg tha se: “Ne jemi të përkushtuar ndaj partneritetit tonë me Ukrainën për një afat të gjatë. Ne do



ta ndihmojmë Ukrainën të kalojë nga epoka sovjetike në pajisjet e standardeve të NATO-s, të vazhdojmë reformën e sektorit tuaj të mbrojtjes dhe sigurisë dhe t’ju ndihmojmë në rrugën e rindërtimit të pasluftës. Në të njëjtën kohë, Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO ka forcuar praninë e saj në lindje të Aleancës sepse garancitë e sigurisë së NATO-s nuk lënë vend për llogaritje të gabuara në Moskë dhe ato u mundësojnë aleatëve të mbështesin të drejtën e Ukrainës

për vetëmbrojtje.

Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO do të vazhdojë të qëndrojë me Ukrainën për aq kohë sa duhet. “Dimri po vjen dhe do të jetë i vështirë. Dhe ajo që ne shohim tani është një luftë gërryese sflitjeje. Kjo është një betejë vullnetesh dhe një betejë logjistike. Prandaj, ne duhet të mbajmë mbështetjen tonë për Ukrainën për një kohë të gjatë, në mënyrë që Ukraina të mbizotërojë, si një komb sovran i pavarur.”

Demonstrimi i aftësive në një mjedis të kontestuar dhe të sofistikuar kërcënim

NATO kryen stërvitje komplekse shumëkombëshe mbi Sllovaki

Avionët luftarakë, bombardues dhe avionët mbështetës të aleatëve kryen një stërvitje në shkallë të gjerë, komplekse, shumëkombëshe mbi krahun lindor të NATO-s, më 22 gusht. Pjesëmarrja e një grupi kaq të larmishëm dhe të aftë të avionëve aleatë demonstroi aftësinë e Aleancës për të reaguar ndaj çdo kërcënimi ndaj kombeve të NATO-s në të gjithë zonën euroatlantike.

Avionët aleatë nga Sllovakia, Franca, Turqia, SHBA dhe MB morën pjesë në një stërvitje shumëkombëshe për të trajnuar ndërveprimin e anëtarëve të Aleancës në një skenar kompleks dhe kërkues. Operacioni me rreze të gjatë, i udhëhequr nga Komanda Ajrore Aleate, u ekzekutua mbi Sllovaki me shumë aleatë që fluturonin nga bazat e tyre.

Formacioni përfshinte avionët luftarakë të gjeneratës së 4-të dhe të 5-të, përfshirë F-22, “Rafales”, MiG-29 dhe “Eurofighter Typhoons” së bashku me bombarduesit B-52, të gjithë të mbështetur nga një numër avionësh ajror për furnizim me karburant. Formacioni operoi ndaj baterive të përbashkëta



gjermano-holandeze, me bazë sipërfaqësore dhe të mbrojtjes raketore Patriot që janë vendosur aktualisht në Sllovaki për të mbrojtur krahun lindor të NATO-s. Pjesëmarrësit përfituan nga trajnimet thelbësore të përbashkëta, përfshirë përdorimin e aftësive të goditjes me saktësi, duke rritur ndërveprueshmërinë e Aleancës dhe duke përmirësuar gatishmërinë.

“Pjesëmarrja e një grupi kaq të larmishëm dhe të aftë të avionëve aleatë demonstroi aftësinë e Aleancës për të reaguar ndaj çdo kërcënimi ndaj kombeve të NATO-s në të gjithë zonën euroatlantike”, - tha maresali Ajror Johnny Stringer, zëvendëskom-

andanti i Komandës Ajrore Aleate. “Fuqia ajrore aleate operon lirshëm dhe me shpejtësi në të gjithë zonën e përgjegjësisë së SACEUR dhe është thelbësore për të garantuar lirinë e aksesit dhe ruajtjen e sigurisë kolektive. Trajnimi i tillë tregon shtrirjen, ndërveprueshmërinë dhe shkathhtësinë e forcave tona që vazhdojnë të mbrojnë të gjitha vendet e NATO-s”, - përfundoi ai. Ky është misioni i parë për bombarduesit B-52 të USAF që pas mbërritjes së tyre në Europë, më 18 gusht, për një tjetër rotacion të planifikuar të Task Force Bomber. Kjo do t’i shohë ata të veprojnë së bashku me aleatët në të gjithë kontinentin gjatë misioneve të ngjashme për dy muajt e ardhshëm. Qëllimi i këtij misioni kompleks shumëkombësh ishte përgatitja e forcave të NATO-s për të vepur në një mjedis të kontestuar dhe të sofistikuar kërcënimi. Kjo siguron një përgjigje të aftë dhe të besueshme ndaj agresionit të mundshëm, të vendosur në sfondin e tensioneve të rritura pas pushtimit rus të Ukrainës. Trajnimi u zhvillua në përpunje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare dhe u ekzekutua brenda hapësirës ajrore të NATO-s

Deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në Platformën Ndërkombëtare të Krimesë

Duke iu drejtuar presidentit Zelenskyy, presidentit Duda dhe Miqve të Ukrainës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg deklaroi se: “Tetë vjet më parë, Rusia aneksoi ilegalisht Krimenë, duke e shndërruar atë në një nga zonat më të militarizuara në Europë dhe duke e përdorur atë si një platformë lëshimi për pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës gjashtë muaj më parë.

Presidenti Putin mendoi se mund të shtypte popullin dhe forcat e armatosura ukrainase. Ai mendonte se mund të përcante kombet tona demokratike. Ai mendoi se mund të diktonte se çfarë të bënin të tjerët. Presidenti Putin gaboi.

Prania e kaq shumë miqve të Ukrainës sot këtu e dëshmon këtë. Ukraina ka vuajtur gjashtë muaj të tmerrshëm lufte. Por ju keni treguar gjithashtu aftësinë tuaj të pabesueshme për t’i rezistuar agresionit brutal. Për të kundërgoditur, për të rimarrë territorin dhe për të imponuar kosto të mëdha ndaj Rusisë. NATO qëndron në solidaritet të plotë me Ukrainën. Aleatët mbështesin plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Të drejtë tuaj për vetëmbrojtje dhe për të zgjedhur rrugën tuaj.

Presidenti Putin filloi këtë luftë të pajustifikuar. Ai duhet ta ndalë këtë luftë. Të tërheqë forcat e tij nga Ukraina!

NATO ka qëndruar me Ukrainën që nga pavarësia juaj. Ne kemi rritur ndjeshëm mbështetjen tonë pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë. Kur Rusia pushtoi përsëri, kjo ndihmoi që forcat e armatosura të Ukrainës të bëhen më të forta, më të trajnuara dhe të udhëhequra më mirë se në vitin 2014. Dhe që nga shkurti, aleatët e NATO-s kanë ofruar ndihmë të paprecedentë ushtarake, financiare dhe humanitare. NATO është pjesë e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës të udhëhequr nga SHBA për të mobilizuar mbështetje dhe unë angazhohem në mënyrë aktive me udhëheqësit për t’i nxitur ata të ofrojnë më shumë armë dhe më shumë municion më shpejt.

Në Samitin tonë të NATO-s në Madrid në qershor, ne ramë dakord për një paketë të forcuar ndihme, përfshirë karburantin, ushqimin, furnizimet mjekësore, pajisjet mbrojtëse ushtarake dhe komunikimet e sigurta, si dhe pajisje për të luftuar minat, dronët, kërcënimet kimike dhe biologjike. Ne kemi mbi një duzinë projekte të reja në përgatitje për dimër. Në të njëjtën kohë, ne kemi forcuar praninë tonë në lindje të Aleancës. Sepse garancitë e sigurisë së NATO-s nuk lënë vend për llogaritje të gabuara në Moskë dhe ato u mundësojnë aleatëve të mbështesin të drejtën e Ukrainës për vetëmbrojtje.

Ne jemi të përkushtuar ndaj partneritetit tonë me Ukrainën për një afat të gjatë. Ne do të ndihmojmë Ukrainën të kalojë nga epoka sovjetike në pajisjet e standardeve të NATO-s. Vazhdoni reformën tuaj në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë t’ju ndihmojë në rrugën e rindërtimit të pasluftës. Dimri po vjen. Dhe do të jetë e vështirë. Dhe ajo që ne shohim tani është një luftë gërryese sflitjeje. Kjo është një betejë vullnetesh dhe një betejë logjistike. Prandaj, ne duhet të mbajmë mbështetjen tonë për Ukrainën për një afat të gjatë, që Ukraina të mbizotërojë, si një komb sovran i pavarur. Një Ukrainë e fortë, e qëndrueshme dhe e pavarur është thelbësore për sigurinë euroatlantike. NATO ka qëndruar me Ukrainën gjatë tre dekadave të pavarësisë. Ne qëndrojmë me Ukrainën tani. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë me Ukrainën. Për aq kohë sa duhet”.

NATO 2022, VJELJA E MJALTIT Selia e NATO-s, zgjua aktiviteti pas një vjeljeje tjetër të suksesshme të mjalit

Që nga prilli 2020, Selia e NATO-s ka qenë shtëpia e një numri kosheresh bletësh si pjesë e një nisme më të gjerë “gjelbërimi”. Duke filluar me dy koshere, kjo tani është dyfishuar në katër për shkak të suksesit të prodhimit të mjalit.

Popullata e bletëve ndryshon gjatë gjithë vitit, duke u rritur në mënyrë të qëndrueshme nga rreth 10 000 në janar për të mbërritur mesatarisht 50 000 bletë për koshere në kulmin e verës kur potenciali për vjeljen e nektarit është më i madh. Një lugë çaji mjalte është e barabartë me prodhimin gjatë gjithë jetës së pesë bletëve, të cilat zakonisht jetojnë për 30-40 ditë gjatë muajve të ngrohtë.

NATO 2022, vjelja e mjalit: Çdo koshere mund të prodhojë rreth 80 deri në 100 kg mjalte në një sezon, pjesa më e madhe e të cilit u lihet bletëve për t’u ushqyer dhe për të mbajtur letargjinë e tyre gjatë muajve të gjatë të dimrit. Më pas vilen mesatarisht 25 kg mjalte në vit nga bletari i NATO-s. Deri më sot, pjesa më e madhe e prodhimit të mjalit është shitur në Pazarin e Bamirësisë së NATO-s për të përfutur projekte të zgjedhura vendore dhe ndërkombëtare.

Instalimi i koshereve ishte pjesë e një projekti më të gjerë për ta bërë selinë e NATO-s “më të gjelbër”. Në prill 2022 u mboll një livadh me lule të egra, i përbërë nga një përzjerje e bimëve dhe luleve autoktone, duke përfshirë lulëkuqe dhe lule misri për të inkurajuar fluturat dhe zogjtë. Bletët e mjalit luajnë një rol jetik në ekosistem, duke polenizuar bimët e lulëzuara, pemët dhe kulturat. Me çdo koshere që mbulon një rreze prej tre kilometrash, bletët po kontribuojnë gjithashtu në mënyrë aktive në mbështetjen e biodiversitetit në komunitetet përreth selisë së NATO-s. Biodiversiteti është aktualisht nën kërcënim për shkak të rritjes së temperaturave dhe aktiviteteve njerëzore, por ruajtja e habitateve natyrore mund të luajë një rol të rëndësishëm në rregullimin e klimës duke ndihmuar në thithjen dhe ruajtjen e karbonit.



NËNKOLONEL (R) KANAN HIMAJ
Instituti i Kërkimit Shkencor Ushtarak

Lufta në Ukrainë ka një ndikim të gjerë, duke ndryshuar jo vetëm arkitekturën e sigurisë në Europë, por duke ndikuar gjeopolitikën pothuajse globalisht. Veprimet agresive të Rusisë dhe sjellja gjithnjë e më sfiduese e Bjellorusisë – e përforcuar nga aftësia ushtarake në rritje e Moskës – vazhdojnë të përbëjnë kërcënimin për sigurinë. Pushtimi i paligjshëm i Krimesë, destabilizimi dhe agresioni ndaj Ukrainës, mbështetja për separatistët dhe mohimi i aspiratës legjitime të Ukrainës për të zgjedhur aleancat e saj janë pjesë e një politike më të gjerë.

Modeli agresiv i Rusisë përforcohet nga rritja e forcave të armatosura, të cilat janë krijuar për të kërcënuar krahun lindor të NATO-s dhe rajonin e Detit të Zi. Lufta në Ukrainë dhe stërvitjet e kombinuara me presionin e vazhdueshëm ushtarak në kufijtë lindorë dhe veriorë të Ukrainës tregojnë se Moska tashmë është e përfshirë në një konflikt me synimin për të shtrirë në pjesën më të madhe të Europës Lindore. Ajo është e angazhuar në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e municioneve të avancuara, të cilat synojnë të krijojnë një avantazh të qartë ndaj NATO-s në zonat që Moska i konsideron jetike për interesat e saj dhe në një kohë që forcat ruse mund të sjellin fuqi të mëdha. Deti Arktik, Svalbard, Kepi i Veriut dhe Finmark, shtetet baltike, Bjellorusia, Ukraina dhe rajoni i Detit të Zi janë të gjitha zona ku Rusia është aktive.

Traktati për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore (NPT) mbetet mburoja thelbësore, gur themeli i arkitekturës globale të mospërhapjes dhe çarmatimit bërthamor, kuadri për bashkëpunimin ndërkombëtar në ndarjen e përfitimeve paqësore të energjisë bërthamore, shkencës dhe teknologjisë.

Kontrolli i armëve konvencionale mbetet si themeli i një arkitekture të qëndrueshme të sigurisë euroatlantike bazuar në parimet dhe angazhimet kryesore, duke përfshirë reciprocitetin, transparencën dhe pëlqimi i kombit pritës. Qëndrimi agresiv i Rusisë, refuzimi për të përmbushur plotësisht detyrimet e saj sipas Traktatit të Qiejve të Hapur, zbatimi i vazhdueshëm selektiv i Dokumentit të Vjenës dhe dështimi i gjatë për të zbatuar Traktatin për Forcat e Armatosura Konvencionale në Europë vazhdojnë të minojnë sigurinë dhe stabilitet në të gjithë Europën.

Rusia e konsideron ofertën e anëtarësimit në BE dhe/ose NATO për Ukrainën një kërcënim shumë të rrezikshëm për interesat e saj jetike të sigurisë dhe ato ekonomike. Një anëtarësim i tillë jo vetëm që do të nënkuptonte që një numër i konsiderueshëm rusësh do të largohej tërësisht nga ndikimi i drejtpërdrejtë rus - ose siç do ta shihte Moska, do të mbeteshin të pambrojtur, por gjithashtu ekonomia e Donbasit do të shpëtohej nga Rusia por dhe Ekonomia Euroaziatike. Nëse ekonomia e Ukrainës Lindore do të zhvillohej në një mënyrë pozitive me ndihmën e investimeve të mëdha europiane dhe amerikane, kjo mund të kishte një efekt domino në Bjellorusi dhe të minonte besueshmërinë e regjimit në vetë Rusinë.

Nga ana tjetër, duhet thënë nëse NATO do të ishte vërtet e gatshme të pranonte një komb me një konflikt të vazhdueshëm me Rusinë, me një fuqi e madhe bërthamore? Në këtë kontekst, nuk duhet harruar se edhe Bashkimi Europian ka një klauzolë të mbrojtjes reciproke. Neni 42 (7) i Traktatit të Lisbonës të vitit 2009 thotë: “Nëse një shtet anëtar është viktimë e agresionit të armatosur në territorin e tij, shtetet e tjera anëtare do të kenë ndaj tij një detyrim për ndihmë me të gjitha mjetet në fuqinë e tyre, në përputhje me nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.”

Në nivel ekonomik, pushtimi rus po rezulton katastrofë për eksportet ruse të gazit dhe naftës, motori i ekonomisë së Rusisë. Rusia humbet klientin e saj më të rëndësishëm, BE-në, e cila synon të arrijë pavarësinë energjetike nga Rusia deri në vitin 2030. Tërheqja e kompanive të mëdha të energjisë dhe shërbimeve të

Ndikimi i gjeopolitikës në konfliktin në Ukrainë



naftës nga tregu rus është i barabartë me një goditje të rëndë që do të rezultojë në dekada të humbura, veçanërisht në lidhje me prodhimin e naftës. BE-ja po konsideron gjithashtu të synojë tregtinë globale ruse të naftës duke vendosur sanksione ndaj transportit detar. Strategjia e gazit rus është fokusuar në transportin përmes tubacioneve të kushtueshme (Nord Stream, Nord Stream 2 [anulluar]), Blue Stream, Yamal Europe, TurkStream) dhe jo në teknologjinë LNG përmes transportit detar. Distanca në zemrën e Euro-Azisë e bëjnë të paktën problematik riorientimin e eksporteve të gazit dhe naftës drejt Kinës ose Indisë.

Megjithatë, monedha ekonomike ka edhe dy anë. Lidhur me ndikimin e Luftës së Ukrainës në sigurinë energjetike dhe prosperitetin ekonomik të Eropës Perëndimore, duhet të theksojmë se vendet e BE-së kanë marrë në vitin 2021 në total 155 bcm (billion cubic meters) gaz (40% e totalit të importeve) dhe 2,3 milionë fuçi në ditë (bpd), nafta bruto (25% e importeve totale) nga Rusia. SHBA, eksportuesi i dytë më i madh i gazit në botë pas Rusisë, eksportoiti në vitin 2021 188 bcm. OPEC prodhon aktualisht rreth 28 milionë bpd, 30% të naftës së papërpunuar në botë, ndërsa Rusia prodhon rreth 10 milionë fuçi në ditë. Një embargo totale mbi naftën dhe gazin rus do të kishte një ndikim jashtëzakonisht negativ në ekonominë europiane.

Ukraina është një nga eksportuesit më të mëdhenj në botë të produkteve bujqësore. Pjesa e vendit në eksportet globale të vajit të farës së lulediellit është 50%, e thekrës 40%, e elbit 17,5%, e misrit 16,5%, dhe e grurit 11,6%. Rusia, e cila përbën 16% të eksporteve botërore të grurit dhe 13% e eksportit të elbit, ka ndaluar pjesërisht eksportet e drithërave. Kjo ka çuar në rritje të ndjeshme të çmimeve të drithit në tregjet globale. Çmimi i grurit ishte rritur tashmë 80% midis prillit 2020 dhe dhjetorit 2021. Rusia ka një pozicion shumë të rëndësishëm në tregun e mallrave minerale, ai është prodhuesi i dytë më i madh i platinit, paladiumit, vanadiumit, kobaltit dhe i treti më i madh i arit dhe nikelit. Kobalti dhe nikeli janë të një rëndësie kritike për prodhimin e baterive litium-jon, rreth 30% e diamanteve në botë. Në tregun e çelikut është vendi i tretë më i madh eksportues në botë. Rusia është gjithashtu një faktor kryesor në industrinë e energjisë bërthamore, disa vende

europiane si Finlanda, Bullgaria, Republika Çeke, Sllovakia dhe Hungaria kanë nevojë për uranium për termocentralet bërthamore.

Disa nga vlerësimet e përgjithshme lidhen me të dhënat që shumica e vendeve të Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore mbështesin politikën amerikane dhe europiane mbi Ukrainën në një mënyrë të vakët. Deri më tani, kërkesat e SHBA-së drejtuar Arabisë Saudite për të rritur prodhimin e saj të naftës për të ulur çmimin global janë refuzuar. Irani e konsideron Rusinë një vend mik dhe Algjeria blen shumicën e pajisjeve ushtarake.

Kina ka miratuar një qëndrim të kujdesshëm deri më tani në mbështetje të Rusisë, ajo nuk e përdori as termin ‘pushtim’, pasi u bëri thirrje të gjitha palëve në Ukrainë që të jenë përgjegjëse dhe të ushtrojnë përmbajtje. Zyrtarët kinezë iu referuan në mënyrë të paqartë rëndësisë së sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial të çdo vendi. Duke mbështetur Rusinë në mënyrë indirekte, ajo i kërkoi SHBA-së të respektojë kërkesat e Rusisë për garancitë e sigurisë. Pas deklaratave politike qëndron realiteti ekonomik. Në një nivel strategjik, Kina nuk dëshiron të minojë perspektivat e projektit të saj madhështor, Nisma e Rugës së Rripit që bashkon Euro-Azinë.

India e konsideron Rusinë një partner të rëndësishëm tregtar, furnizuesin kryesor të armëve. Rreth 450 avionë luftarakë (Su-30MKI, MiG-29 UPG dhe MiG-21 Bison), sisteme të shumta të mbrojtjes ajrore, nëndetëse dhe fregata. Më shumë se 3 000 tanke luftarake T-72 Ajeya dhe T-90S, si dhe 2 500 automjete luftarake të këmbësorisë BMP-2. Ka një bashkëpunim të ngushtë në projektet energjetike, duke përfshirë edhe termocentralet bërthamore.

Për sa më lart, duke mbajtur parasysh gjendjen ekonomike në tërësi, gjeopolitika e sotme globale është vështirësuar dhe me shume të papritura për sigurinë e vendeve.

Europa po ruan balanca të forta politike, diplomatike, ekonomike dhe masa shtesë sigurie me organizmat ndërkombëtare të sigurisë si NATO, OKB, OSBE për situatën në kufijtë lindor të saj por edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo është panorama e cila do të vijojë për një periudhë të gjatë që mbetet në konsideratën e gjithë aktorëve të rëndësishëm rajonalë dhe global.

Mbrojtja kibernetike, më shumë se një çështje IT-je

Sulmet kibernetike më të fundit

Pas 24 shkurtit, me fillimin e pushtimit rus në Ukrainë, Rusia ka ndërmarrë një sërë sulmesh për shumë shtete aleate të Ukrainës. Një ndër vendet e prekura nga sulmet kibernetike është edhe Shqipëria. Nëpërmjet platformave të monitorimit për sigurinë kibernetike të ngritura për sistemet dhe infrastrukturat qeveritare shqiptare, u vu re një sulm kibernetik kompleks dhe në shkallë të gjerë, ndaj platformës qeveritare e-Albania. Menjëherë, duke ndjekur protokollet e reagimit, u krye izolimi i infrastrukturave dhe sistemeve qeveritare për të garantuar mbrojtjen e të dhënave. Metodatat mbi të cilat aktorët keqbërës kanë vepruar janë të ngjashme me sulmet e vitit të fundit, të vëna re në hapësirën kibernetike ndërkombëtare. Teknikat mbi të cilat ky sulm mbështetet ishin të së njëjtës natyre me ato të përdorura për një sërë sulmesh kibernetike në domain-et qeveritare dhe private të kohëve të fundit, si në Ukrainë, Gjermani, Lituani, Maltë, Holandë, Belgjikë dhe vende të tjera të rajonit”. Detektimi dhe përgjigja e shpejtë ndaj këtyre sulmeve bëri që sistemet qeveritare të dalin të paprekura.

Ndërkaq, në gjithë këtë situatë, në korrik të 2012 Prokuroria e Romës, Itali, hapi një hetim për të kryer kontrolle mbi sulmin e hakerëve ndaj “Agenzia delle Entrate”, të raportuar në dark web nga “LockBit”, e cila pretendonte se kishte vjedhur 78 gigabajt të dhëna përmes malware.

Sipas ekspertëve, sulmi do të ishte vepër e “LockBit”, një grup hakerësh që operojnë në mbarë botën në aktivitetet e ramsonware dhe që do t’i kishte dhënë Agjencisë një ultimatum pesëditor si një formë shantazhi, nën dënimin e zbulimit dhe shpërndarjes së të dhënave të vjedhura. Sulmi dyshohet se është kryer duke shkelur profilin e një përdoruesi. Hakerët postuan një seri pamjesh të ekranit në lidhje me sulmin dhe pikërisht duke analizuar këtë të fundit dhe llojin e materialit që do të ishte vjedhur, hetuesit dhe ekspertët supozojnë se është sulmuar profili i një përdoruesi dhe nuk është bërë nga “Agenzia delle Entrate”.

Më 25 korrik 2022, në objektet AMEOS në Neuburg, sistemi i sigurisë IT i Grupit AMEOS kishte raportuar një rritje të të ashtuquajturave posta phishing. Masat e sigurisë që u morën menjëherë parandaluan përhapjen e postave elektronike të infektuara ose instalimeve të palëve të treta me defekt.

Taipei, Tajvan, më 4 gusht, Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit tha se uebfaqja e saj pësoi sulme kibernetike dhe u shkëput përkohësisht, duke shtuar se po punonte ngushtë me autoritetet e tjera për të rritur sigurinë kibernetike ndërsa tensionet me Kinën rriten. Disa uebsajte qeveritare, përfshirë zyrën presidenciale, iu nënshtruan sulmeve kibernetike nga jashtë shtetit, disa prej të cilave autoritetet thanë se ishin nisur nga Kina dhe Rusia.

Iran, korrik 2022, hakerët shënjestruan Organizatën Islamike të Kulturës dhe Komunikimit të Iranit (ICCO). Sulmi shkatërroi të paktën 6 faqe interneti, vendosi imazhe të liderëve të rezistencës iraniane në pesëmbëdhjetë faqe të tjera, fshiu bazat e të dhënave dhe kompjuterët dhe lejoi hakerët të merrnin akses në të dhënat e ndjeshme të ICCO.

Belgjikë, korrik 2022, Ministria e Jashtme e Belgjikës akuzoi Kinën për një fushatë kibernetike spiunazhi kundër objektivave belge, duke përfshirë Ministrinë e Brendshme dhe të Mbrojtjes të Belgjikës. Një zëdhënës i ambasadës kineze në Belgjikë mohoi akuzat.

Britani, korrik 2022, hakerët synuan llogaritë e mediave sociale në pronësi të Ushtrisë Mbretërore Britanike. Sulmi përfshinte marrjen e llogarive të Ushtrisë Britanike në Twitter dhe YouTube.

Lituani, korrik 2022, hakerët shënjestruan ofruesin shtetëror Lituanisë për energjinë në një sulm DDoS. “Killnet”, të cilin zyrtarët lituanes e lidhin me Rusinë, mori përgjegjësinë për sulmin.

Ukrainë, korrik 2022, hakerët shkelën një kompani media-tike ukrainase për të transmetuar në radio stacione të shumta se presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy ishte në gjendje kritike. Zelenskyy hodhi poshtë pretendimet dhe fajësoi Rusinë për sulmin.

Kinë, korrik 2022, Kina deklaroi se Shtetet e Bashkuara vodhën 97 miliardë pjesë të të dhënave globale të internetit dhe 124 miliardë pjesë të të dhënave telefonike në qershor, duke fajësuar veçanërisht Zyrën e Operacioneve të Përshtatura të Aksesit (TAO) të Agjencisë Kombëtare të Sigurisë (NSA).

Lituani, qershor 2022, hakerët shënjestruan hekurudhat shtetërore të Lituanisë, aeroportet, kompanitë e medias dhe ministritë e qeverisë me sulme DDoS. Një grup hakerësh i mbështetur nga Rusia mori përgjegjësinë për sulmin.

SHBA, qershor 2022, FBI, Agjencia e Sigurisë Kombëtare



(NSA) dhe CISA njoftuan se hakerët e sponsorizuar nga shteti kinez synonin dhe shkelnin kompanitë kryesore të telekomunikacionit dhe ofruesit e shërbimeve të rrjetit që të paktën që nga viti 2020.

Izrael, qershor 2022, hakerët shënjestruan ish-zyrtarët izraelitë, personelin ushtarak dhe një ish-ambasador të SHBA-ve në Izrael. Një firmë izraelite e sigurisë kibernetike deklaroi se aktorë të lidhur me Iranin përdorën një fushatë phishing për të fituar akses në kutitë hyrëse të objektivave, informacionin personal të identifikueshëm dhe dokumentet e identitetit.

Iran, qershor 2022, hakerët synuan tre kompani iraniane të çelikut, duke e detyruar fabrikën shtetërore të vendit të ndalojë prodhimin.

Hakerët zbuluan skedarë dhe foto të njohura si “Dosjet e Policisë Xinjiang” që shfaqin abuzimet e të drejtave të njeriut të kryera nga qeveria kineze kundër popullsisë ujgure.

Një sulm synoi përdoruesit e platformës më të madhe kineze të Australisë, Media Today. Hakerët bënë mbi 20 milionë përpjekje për të rivendosur fjalëkalimet e përdoruesve në sistemin e regjistrimit të platformës.

Jeruzalem, qershor 2022, hakerët synuan sistemet e adresave publike komunale në Jerusalem dhe Eliat, duke shkaktuar sistemet e sirenavë të sulmit ajror në të dy qytetet. Një firmë industriale izraelite e sigurisë kibernetike ia atribuoi sulmin Iranit.

Australi, qershor 2022, një fushatë dezinformuese e lidhur me Kinën synoi kompaninë australiane të minierave “Lynas Rare Earths”. Fushata përfshinte përhapjen e dezinformatave në platformat e mediave sociale dhe faqet e internetit në lidhje me të dhënat e pretenduara mjedisore të “Lynas Rare Earths”.

Norvegji, qershor 2022, hakerët shënjestruan institucionet publike norvegjeze me sulme DDoS, duke prishur faqet e internetit të qeverisë. Autoriteti norvegjez i sigurisë NSM ia atribuoi sulmin hakerëve pro-rusë.

Londër, maj 2022, një sulm DDoS synoi Autoritetin e Portit të Londrës, duke e detyruar uebsajtin e tij të dilte jashtë linje. Një grup i lidhur me Iranin mori përgjegjësinë për hakimin.

Jordani, maj 2022, një fushatë phishing synoi Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jordanisë. Studiuesit ia atribuuan sulmin një aktori iranien të spiunazhit kibernetik.

Itali, maj 2022, hakerët rusë goditën faqet e internetit italiane me një sulm DDoS, duke përfshirë Senatën, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit. Grupi thotë se qëllimi i tij ishte të synonte vendet e NATO-s dhe Ukrainën.

Rumani, prill 2022, Drejtoria Kombëtare Rumune e Sigurisë Kibernetike tha se uebfaqet e shumta të sektorit publik dhe privat u goditën me sulme DDoS. Viktimat përfshinin ministrinë e mbrojtjes, policinë kufitare, kompaninë kombëtare të hekurudhave dhe OTP Bank. Një grup që pretendon meritën për sulmin tha se ka hakuar faqet e internetit sepse Rumania ka mbështetur Ukrainën që nga pushtimi rus i vendit.

Prill 2022, studiuesit e sigurisë kibernetike identifikuan një fushatë të re nga hakerët e lidhur me Rusinë që filloi në janar dhe synon diplomatë dhe zyrtarë të ambasadave nga Franca, Polonia, Portugalia dhe vende të tjera. Hakimet filluan me një “email phishing” për të dërguar një skedar të ngarkuar me malware në objektiv.

Iran, prill 2022, televizioni shtetëror iranien pretendoi se qeveria pengoi ndërhyrjet kibernetike që synonin më shumë se

100 agjenci të sektorit publik. Ata nuk dhanë informacione të mëtejshme për ngjarjen.

Kosta Rika, prill 2022, hakerët rusë shënjestruan Ministrinë e Financave të Kosta Rikës në një sulm kibernetik, duke dëmtuar sistemet e mbledhjes së taksave dhe eksportit. Presidenti i sapo zgjedhur i Kosta Rikës shpalli një emergjencë kombëtare si rezultat i sulmit dhe grupi kërkoi 20 milionë dollarë shpërblim ose planifikon të nxjerrë të dhënat e vjedhura.

Prill 2022, hakerët shënjestruan anëtarët e Komisionit Euro-pian me spyware të zhvilluar nga “NSO Group”. Një njoftim i “Apple” nga nëntori për mijëra përdorues të “iPhone”, duke thënë se ata ishin në shënjestër nga aktori i sponsorizuar nga shteti, paralajmëroi Komisionin për këtë përdorim spyware.

Kore Veriut, prill 2022, një fushatë hakerimi e lidhur me Korenë e Veriut duke përdorur email phishing të dërguara nga rekrutuesit e rremë të punës, synonte kompani kimike në Korenë e Jugut.

SHBA, prill 2022, Zyra e Kontrollit të Pasurive të Huaja e Departamentit të Thesarit ia atribuoi sulmin e 29 marsit të “Ronin Network” një grupi hakerësh të Koresë së Veriut dhe njoftoi sanksione kundër hakerëve. Grupi vodhi mbi 540 milionë dollarë në “Ethereum” dhe USDC.

Finlandë, prill 2022, hakerët nisën sulme DDoS kundër faqeve të internetit që i përkasin Ministrive Finlandeze të Mbrojtjes dhe Punëve të Jashtme. Botnet-i i sulmit përdori mbi 350 adresa IP nga e gjithë bota dhe mohimi i shërbimit u mbajt për katër orë.

Aktorët kibernetikë të lidhur me Hamasin përdorën një rrjet profilesh të rreme në Facebook dhe Twitter për të vëzhguar anëtarët e institucionit të sigurisë izraelite. Aktorët përdorën gjithashtu WhatsApp për të rritur besimin me objektivat e tyre, më pas u kërkuar atyre të shkarkonin një aplikacion me malware.

Ukrainë, prill 2022, hakerët shënjestruan llogaritë e Telegramit të zyrtarëve të qeverisë ukrainase me një sulm phishing në një përpjekje për të fituar akses në llogaritë.

Studiuesit e sigurisë kibernetike vëzhguan hakerët që depërtonin në rrjetet e të paktën 7 Qendrave Shtetërore të Dispeçerit të Ngarkesës Indiane (SLDC) të cilat mbikëqyrin operacionet për kontrollin e rrjetit elektrik. SLDC-të menaxhojnë sistemet SCADA dhe studiuesit sugjeruan se mund të përfshihen hakerë të lidhur me PLA.

Një platformë e mediave sociale ndërpreu dy fushata spiunazhi kibernetik të lidhura me Iranin që synonin aktivistët, akademikët dhe kompanitë private. Fushata synoi bizneset në sektorët e energjisë, gjysmëpërquesve dhe telekomunikacionit në vende duke përfshirë SHBA-në, Izraelin, Rusinë dhe Kadanë duke përdorur phishing dhe teknika të tjera të inxhinierisë sociale.

Sipas studiuesve, një grup synoi disa organizata mediatike ukrainase në një përpjekje për të fituar akses afatgjatë në rrjetet e tyre dhe për të mbledhur informacione të ndjeshme. Grupi ka lidhje me GRU-në ruse.

Shtetet e Bashkuara hoqën malware rus nga rrjetet kompjuterike në mbarë botën, një lëvizje e bërë publike nga Prokurori i Përgjithshëm Merrick B. Garland. Ndërsa është e paqartë se cili ishte qëllimi i malware, autoritetet vunë në dukje se ai mund të përdoret nga çdo gjë, nga survejimi deri te sulmet shkatërruese. Malware krijoi një botnet të kontrolluar nga GRU ruse.

Hakerët shënjestruan një objekt energjetik të Ukrainës, por CERT-UA dhe ndihma e sektorit privat penguan kryesisht përpjekjet për të mbyllur nënstacionet elektrike në Ukrainë. Studiuesit besojnë se sulmi erdhi nga i njëjti grup me lidhje me GRU-në ruse që synoi rrjetin elektrik të Ukrainës në vitin 2016, duke përdorur një formë të përditësuar të të njëjtit malware.

...
Çfarë po vjen më pas për industrinë e sigurisë kibernetike?

Shpenzimet për sigurinë kibernetike nuk ka gjasa të ngadalësohen së shpejti. Korporata Ndërkombëtare e të Dhënave (IDC) parashikon që shpenzimet e sigurisë kibernetike në mbarë botën do të arrijnë në 174.7 miliardë dollarë në vitin 2024, me shërbimet e sigurisë dhe me rritjen më të shpejtë të tregut.

Rritja e sulmeve kibernetike, veçanërisht ransomware, ka nxitur tregun e sigurimeve kibernetike. “GlobalData”, një lider në të dhëna dhe analitikë, parashikoi që industria do të arrijë 8.92 miliardë dollarë në 2021 dhe më shumë se dyfish në 20.6 miliardë dollarë deri në vitin 2025.

